

PAULIN MARKU

**PËR PJEKJA E PERANDORISË OSMANE
PËR TË STABILIZUAR SITUATËN NË VISET SHQIPTARE:
KOMISIONI I REFORMAVE I HAXHI ADIL BEUT
(SHKURT-PRILL 1912)**

Në fillim të vitit 1912, popullsia shqiptare e vilajeteve të Kosovës, Shkodrës, Manastirit dhe Janinës gjendej në një situatë të vështirë ekonomike, politike dhe shoqërore. Shqiptarët manifestuan gjithnjë e më tepër një pakënaqësi në rritje si ndaj angazhimit të pakët të qeverisë për zbatimin e marrëveshjes së një viti më parë*, ashtu edhe ndaj masave ekonomike me taksa të larta që bëheshin të papërbalueshme, çarmatimin e popullsisë, shërbimin e detyruar ushtarak si dhe ndaj administratës.

Kriza me faktor të jashtëm** dhe të brendshëm*** kishte mbërthyer Perandorinë Osmane dhe qeverisjen xhonturke.¹ Komiteti “Bashkim e Përparim” me anë të politikës centralizuese dhe ideologjisë së

* Marrëveshja prej 12 pikash u nënshkrua me 2 gusht 1911 në Podgoricë, nga përfaqësuesi i qeverisë osmane, Sadedin Beu dhe u zyrtarizua më 4 gusht 1911. Sadedin Beu i dorëzoi një kopje të marrëveshjes si garanci zbatimi, qeverisë malazeze (që ishte edhe ndërmjetëse e malësorëve) dhe nga një kopje Fuqive të Mëdha. Shqiptarët e pranuan marrëveshjen edhe pse te pjesshme në interes të qeverisë xhonturke dhe u kthyen në zonat e tyre.

** Më 4 tetor 1911 trupat italiane kishin zbarkuar në Tripolitani. Brenda disa javësh ata shtinë në dorë zonat bregdetare. Në fillim të nëntorit, Italia shpalli zyrtarisht pushtimin e Tripolit dhe të Bengazit. Për më tepër *shih*: Robert Mantran, *Historia e Perandorisë Osmane*, Tiranë: Dituria, 2004, f. 555-556.

*** Për këtë çështje ishin fajësuar disa ministra të kabinetit xhonturk si shkaktarë të ngjarjeve të rënda që i kushtoi shumë qeverisë së Haki Pashës me dorëheqjen e tij, në tetor të vitit 1911. Shpërndarja e parlamentit çonte në shtyrjen e hetimit ndaj ish qeveritarëve deri në miratimin e parlamentareve të rinj. Po ashtu çështja shqiptare po hapte debate të ashpra me akuza të forta ndaj kabinetit të qeverisë xhonturke, çka dobësonte pozitën e tyre në viset shqiptare. Përplasjet në parlament mes përfaqësuesve shqiptarë dhe atyre xhonturq ishin temë kryesore e debateve në çdo seancë.

¹ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. II (Rilindja Kombëtare, vitet 30 të shek. XIX-1912), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2002, f. 462.

“otomanizmit” synonte të mbetej sundues në Perandorinë Osmane.² Kështu, pozita drejtuese e xhonturqve me politikën e otomanizmit ishte bërë edhe më e padurueshme për kombësitë e tjera.³

Në vitet 1911-1912, nacionalizmi turk filloi të organizohet dhe të forcohet me objektiv, shtrirje e influencë brenda Perandorisë Osmane.⁴ Joseph Swire, shprehet se, një autokrat ishte zëvendësuar nga një grup zyrtarësh të korruptuar dhe fanatikë⁵, çka sillte mjaft pakënaqësi në popull dhe i detyronte ata të kundërshtonin me mënyra të ndryshme urdhrat e Portës së Lartë. Këto ishin shkaqet kryesore që nxitën edhe më tepër shqiptarët brenda dhe jashtë parlamentit, të përqaфонin dhe mbështesnin ideologjinë e tyre kombëtare.

Faktori shqiptar, ka pasur vendin dhe rolin e tij në situatën në Ballkan sepse Lëvizja Kombëtare Shqiptare po përjetonte një fazë ringjalljeje të re të fuqishme, jo vetëm me kryengritje por edhe me veprimtari të ndërgjegjshme politike të cilat ishin gjithnjë e në rritje. Shqetësimet për politikën centralizuese osmane dhe masat e marra në terren ishin bërë pjesë e debateve parlamentare, ku deputetët shqiptarë kishin kritikuar ashpër qeverinë, por pa rezultat. Të kota rezultuan përpjekjet e Ismail Qemal Vlorës dhe Hasan Prishtinës, për ndërmarrjen e reformave politike-ekonomike e kulturore në të gjitha vilajetet e Rumelisë. Po kështu edhe përpjekja e deputetit H. Prishtina për ta bindur ministrin osman të Punëve të Jashtme, Asim Beun se ishte në interes të Perandorisë Osmane që të deklaronte zyrtarisht kufijtë e Shqipërisë.⁶

Seancat parlamentare të janarit të 1912-ës u shoqëruan me tone të ashpra dhe me akuza mes deputetëve shqiptarë dhe përfaqësuesve të qeverisë xhonturke. Shqiptarët akuzonin qeverinë për mohimin e të drejtave kombëtare; shkelje të parimeve kushtetuese dhe moszbatim të reformave, ndërsa kjo e fundit akuzonte një pjesë të tyre për rebelizëm, që synonte shpërbërjen e Perandorisë Osmane⁷. Kështu tentativat e

² Sali Kadria, “Mbi disa çështje të Kryengritjes Shqiptare të vitit 1912”, në *Studime historike*, nr. 1-2, Tiranë: 2016, f. 116.

³ Joseph Swire, *Shqipëria, ngritja e një mbretërie*, Tiranë: Dituria, 2005, f. 104.

⁴ R. Mantran, *Historia e Perandorisë Osmane ...*, f. 558.

⁵ J. Swire, *Shqipëria, ngritja e një mbretërie ...*, f. 104.

⁶ Zekeria Cana, “Kryengritjet shqiptare të vitit 1912 në dritën e burimeve serbe”, në *Kosova*, nr 29/30, 2007/2008, Prishtinë: 2008 f. 176.

⁷ Marenglen Verli, Nga *Kosova për Kosovën*, profile biografike, vëll. I, Tiranë: Botimpex, 2006, f. 243.

deputetëve shqiptarë për të paraqitur kërkesat në parlament rezultuan të kota. Edhe më optimisti midis tyre hoqi dorë nga besnikëria ndaj Komitetit “Bashkim e Përparim”, përfshirë edhe Esat Pashën i cili u bashkua në çështjen e nacionalizmit.⁸

Për situatën e tensionuar mes deputetëve shqiptarë dhe qeverisë xhonturke raportonte edhe Bosdari, ministri Fuqiplotë italian në Sofje. Në një relacion dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme, diplomati italian njoftonte gjendjen e rëndë që mbretëronte në Shqipëri, si edhe për seancat e zjarra parlamentare, të shoqëruara me akuza dhe debate reciproke⁹.

Perandoria Osmane gjendej përballë rreziqesh: *së pari* lufta me Italinë për Tripolin e kishte dobësuar së brendshmi dhe së jashtmi; *së dyti* krijimi i shtetit autonom shqiptar po bëhej çështje e ditës. Ai së bashku me një shtet të mundshëm maqedonas, mund të prishte unitetin territorial dhe shtetëror osman; *së treti*, synimet ekspansioniste të monarkive ballkanike për të copëtuar dhe aneksuar territore sa më të gjëra osmane ishin në rritje.

Në këto rrethana, më 18 janar 1912 u vendos shpërndarja e Parlamentit Osman. Mehmeti i V-të shpërndau parlamentin dhe bëri thirrje për organizimin e zgjedhjeve të reja parlamentare.¹⁰ Sipas historianit Antonello Biagini shpërndarja e parlamentit, konsiderohet si një ndër gabimet më të mëdha të Turqve të Rinj¹¹, veprim që shtoi pakënaqësitë e deputetëve shqiptarë, duke bërë që përpjekjet e tyre të shtrihen brenda dhe jashtë viseve shqiptare¹².

Nga mesi i janarit të vitit 1912, me iniciativë të Ismail Qemal Vlorës në lagjen Taksim të Stambollit* u mbajt një mbledhje, ku deputetë shqiptarë pjesëmarrës diskutuan rreth gjendjes së rëndë politike, ekonomike dhe shoqërore që po përjetonte popullsia shqiptare. Në përfundim, ata vendosën që shqiptarët nuk kishin rrugë tjetër pos organizimit të një kryengritjeje të përgjithshme për të fituar të drejtat

⁸ J. Swire, *Shqipëria, ngritja e një mbretërie ...*, f. 103.

⁹ *Archivio Storico Diplomatico di Ministero degli Affari Esteri*, Roma (më tej: *AMAE*), Fondi: Serie Politica “P” (1891–1916), Pacco 674, marrë në *Arkivi i Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), image 7445. Telegram i ministrit Fuqiplotë të Italisë në Sofje, Bosdari, dërguar Ministrisë së Jashtme, Sofje, 1 janar 1912.

¹⁰ George Gawrych, *Gjysmëhëna dhe shqiponja*, Tiranë: Bota shqiptare, 2007, f. 291.

¹¹ Antonello Biagini, *Storia dell’Albania dalle origini ai giorni nostri*, Milano: Bompiani, 1999, f. 74.

¹² *Po aty*.

kombëtare dhe përmirësuar situatën politike dhe ekonomike. Unanimisht u vendos që forcat kryengritëse në verilindje të Shqipërisë do t'i organizonte Hasan Prishtina, i cili do të nisej sa më parë për në Kosovë; Esat Pashë Toptani do të merrej me organizimin në Shqipërinë e Mesme dhe Mirditë, ndërsa Syrja Vlora në Shqipërinë e Jugut. Ismail Qemali do të shkonte në Evropë për të kërkuar ndihmë dhe mbështetje diplomatike, si dhe të ftonte të gjithë shqiptarët që jetonin jashtë për të kontribuar për kryengritjen, që do të duhej të shpërthente në pranverë¹³.

Përpjekjet e qeverisë për qetësimin e situatës: Krijimi i “Komisionit të Reformave”

Kabineti i porsaformuar i Said Pashës mori një karakter më të fortë partiak. Ky Komitet mund të përdorte në dobi të tij, ligjet mbi shtypin, mbi mbledhjet dhe shoqatat.¹⁴ Në qeverinë e re u emëruan persona të cilët kishin ndikim në komitetin “Bashkim e Përparim”. Bie në sy emërimi i Haxhi Adil Beut në postin e ministrit të Brendshëm, njeri me shumë influencë në Komitetin “Bashkim e Përparim”, për të cilin shprehej besueshmëri dhe optimizëm për kryerjen e detyrës. Komiteti u hodh në veprim për të fituar pushtet politik në zgjedhjet e ardhshme, për të vendosur disiplinë në parti dhe për të përjashtuar anëtarët e pavarur në mendime që nuk shkonin në linjën e qeverisë.¹⁵

Nga ana tjetër, kabineti ishte i vetëdijshëm se po humbiste besimin dhe mbështetjen e popullsisë së zonave të Rumelisë. Shqiptarët prej kohësh kishin qenë një nga shtyllat e shtetit osman. Në lëvizjen xhonturke luajtën rol të dorës së parë por gjatë qeverisjes së Turqve të Rinj ata patën pakënaqësi të shumta me pasoja në malësitë shqiptare.¹⁶ Qeveria kishte informacione se në viset shqiptare po përgatitej një lëvizje kryengritëse, e cila drejtohej nga deputetë shqiptarë.¹⁷ Për shqetësimet që po përjetonte qeveria e Stambollit në lidhje me situatën shqiptare, njoftonte edhe ambasadori italian në Vjenë, Avarna. Në telegramin nr. 82

¹³ *Historia e Shqipërisë (vitet 30 të shek. XIX-1912)*, vëll. II, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1984, f. 466.

¹⁴ R. Mantran, *Historia e Perandorisë Osmane ...*, f. 557.

¹⁵ G. Gawrych, *Gjysmëhëna dhe shqiponja ...*, f. 291.

¹⁶ R. Mantran, *Historia e Perandorisë Osmane...*, f. 556.

¹⁷ Ramiz Abdyl, *Lëvizja Kombëtare shqiptare (1911-1912)*, Libri 2, Prishtinë: KGT, 2004, f. 163.

dërguar Ministrisë së Jashtme, më 1 shkurt 1912 shkruante se: “i rezultonte që Porta e Lartë ishte në tension dhe ka si qëllim të emërojë një komision, i cili duhet të ekzaminojë gjendjen në Shqipëri dhe të përgatisë një raport për këtë qëllim”.¹⁸ Lajme shqetësuese vinin edhe nga ministri fuqiplotë italian në Athinë, Carlotti. Ai bënte me dije se agjentët e huaj që kalojnë në këtë vend bëjnë një punë aktive për të përgatitur revoltën në pranverën e vitit 1912.¹⁹

Në dobi të unitetit shtetëror, kabineti ishte i ndërgjegjshëm se duhej të bënte të gjitha përpjekjet për të qetësuar shqiptarët, pse jo edhe për të fituar besimin e tyre. Zgjedhjet parlamentare, të cilat do të mbaheshin në pranverë e nxitën Portën e Lartë që të merrte seriozisht ankesat e shqiptarëve. Ata i dhanë rëndësi të veçantë trazirave që vinin nga viset shqiptare pasi aty qe i gjallë shpirti luftarak.²⁰ Deputetëve shqiptarë i premtuan nxitjen e reformave në vilajetin e Rumelisë në dobi të zgjedhjes së funksionarëve të duhur; forcimit dhe riorganizimit të xhandarmërisë; zgjedhjes së gjykatësve të përshtatshëm; ndërtimin e rrugëve dhe hekurudhave; ndërtimin e burgjeve; masa në arsim; investime për lundrimin në Bunë dhe në liqenin e Shkodrës.²¹ Çështja e alfabetit dhe mësimit në gjuhën shqipe ishte një problem i vjetër për shqiptarët. Në veri kishte alfabetet e ndryshme ndërsa në pjesën jugore përdorej ai latin. Në fund të shek. XIX në mes të myslimanëve u forcua lëvizja për mësime në gjuhën shqipe. Kjo lëvizje njohu një zhvillim të vullshëm në Shqipërinë e Mesme dhe të Jugut.²² Xhonturqit shpresonin të bënin për vete shqiptarët duke bërë lëshime në çështjen e shkollave, duke iu deklaruar se pajtohet me ta se mësimi duhet të jetë në gjuhën shqipe si në fillore ashtu edhe në të mesmen, të emërohen mësues të rinj dhe të hapen

¹⁸ AMAE në AIH, Fondi: Serie Politica “P” (1891 – 1916), Pacco 674, image 6925. Telegram i ambasadorit italian në Austro-Hungari për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Vjenë, 1 shkurt 1912.

¹⁹ Po aty, image 7244, 7245, 7246. Telegram i ambasadorit italian në Athinë Carlotti, dërguar Ministrisë së Jashtme, Athinë, 5 shkurt 1912.

²⁰ Stavro Skëndi, *Zgjidhjet kombëtare shqiptare*, Tiranë: Maluka, 2000, f. 382.

²¹ AMAE në AIH, Fondi: Serie Politica “P” (1891 – 1916), Pacco 674, image 7244, 7245, 7246. Telegram i ambasadorit italian në Athinë Carlotti, dërguar Ministrisë së Jashtme, Athinë, 5 shkurt 1912.

²² Nuray Bozborra, *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorinë Osmane*, Tiranë, Dituria, 2002, f. 201.

shkolla të reja aty ku të shihet e nevojshme.²³ Por nëpunësit e dërguar në vilajetet shqiptare u përpoqën të propagandonin shkrimin arabo-turk për gjuhën shqipe.²⁴

Sakaq, më 25 janar 1912, kabineti osman²⁵ vendosi të dërgojë një komision të posaçëm për reformat në viset shqiptare. Komisioni, i njohur si “Komisioni për Reformat”, do të drejtohej nga Haxhi Adil Beu, ministri osman i Punëve të Brendshme. Me të marrë detyrën, ministri njoftoi deputetët se Komisioni i Reformave do të fillonte punë në gjysmën e dytë të shkurtit. Për afro tre muaj ai do të qëndronte në terren për të njohur konkretisht situatën dhe për kryerjen e reformave të mundshme që ishin më emergjente për shqiptarët. Hapi që ndërmoi qeveria, linte të kuptohej se ankesat e shqiptarëve nuk ishin marrë seriozisht.²⁶ Komisioni duhej të tregojë i gatshëm për bashkëpunim me shqiptarët; t’i ftonte ata të distancoheshin nga lëvizjet kryengritëse të armatosura; të rifitonte besimin duke iu kërkuar të bashkoheshin me Komitetin “Bashkim e Përparim” në zgjedhjet e ardhshme. Pra, qëllimi i Komisionit të Reformave në vetvete nuk ishte vetëm për reformat siç pritej por në thelb kishte edhe qëllime të tjera.

Qeveria kishte propozuar që pjesë e komisionit të ishin edhe ekspertë të huaj. Kështu, ministri osman do të shoqërohej, ndër të tjerë, nga ish konsulli britanik Graves*, konti Ostrorog, ish funksionar në ministrinë britanike të Drejtësisë*, koloneli francez Foulon*, Lejtnant Buman Pasha*²⁷. Pjesëmarrja e të huajve në komision kishte rëndësi të veçantë për dy motive: së pari për shkak të profesionalizmit dhe eksperiencës së tyre; së dyti, qeveria osmane dëshironte t’i demonstronte

²³ Peter Bartl, *Myslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare* (1878–1912), Tiranë: Dituria, 2006, f. 219.

²⁴ *Po aty*, f. 219-220.

²⁵ R. Abdyli, *Lëvizja Kombëtare shqiptare...*, Libri 2, f. 163.

²⁶ J. Swire, *Shqipëria, ngritja e një mbretërie...*, f. 104.

²⁷ *AMAE në AIH*, Fondi: Serie Politica “P” (1891–1916), Pacco 674, image 7287, 7288, 7289. Telegram i ambasadorit italian në Athinë Carlotti dërguar Ministrisë së Jashtme, Athinë, 6 mars 1912; *po aty*, image 6885. Telegram i ministrit Fuqplotë italian në Sofje Bosdari, dërguar Ministrisë së Jashtme, Sofje, 9 mars 1912; *po aty*, image 6888. Telegram i ministrit Fuqplotë italian në Sofje Bosdari, dërguar Ministrisë së Jashtme, Sofje, 10 mars 1912; *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1912)*, vëll. I, përgatitur për botim nga Beqir Meta, Sokol Gjermëni, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2014, f. 222. Raport i ambasadorit Pallavicini nga Kostandinopoja, drejtuar kontit Aehrenthal, Kostandinopojë, 15 shkurt 1912.

shqiptarëve dhe ndërkombëtarëve seriozitetin e iniciativës së saj. Italiani, Carlotti shprehej se përfaqësimi i të huajve në Komisionin e reformave, paraqitej para syve të shqiptarëve si garant i Fuqive të Mëdha për premtimet e qeverisë.²⁸ Këtë e pohonte edhe ambasadori i Francës në Stamboll se Haxhi Adil Beu dëshironte të kishte pranë dëshmitarin anglez Gravez, raporti i të cilit mund të ndryshojë përshtypjen e krijuar në Angli nga botimet e “Balkans Comite”.²⁹ Pra, përfshirja e tyre në komision kishte për qëllim të forconte besimin tek faktorë të brendshëm dhe të jashtëm, në seriozitetin e qeverisë së riformuar të Said Pashës.

Pjesë e këtij komisioni ishin edhe disa funksionarë shqiptarë si: Maz-har Beu^{*}, Halil Rexhai Beu^{**}, Buharedin Beu^{***}, Masar Beu^{****}, Xhevdet Beu^{*****}, Hajdar Beu^{*****}, Bedri Nuri Beu^{*****}, Osman Beu^{*****}.³⁰ Shqiptarët që shoqëruan ministrin, përveç se ishin pjesë e qeverisë ata mbështesnin Turqit e Rinj dhe shpresonin që nëpërmjet bashkëpunimit të mundin të fitonin njohjen e së drejtës për zhvillimin kulturor kombëtar të bashkëkombësve tyre.³¹

Komisionit për Reforma i bëri jehonë të madhe edhe shtypi qeveritar. Gjatë kësaj periudhe, u botuan disa artikuj që flisnin për rëndësinë e “Komisionit” që drejtohej nga ministri i Brendshëm dhe përparësitë që do kishte në forcimin e xhandarmërisë; ndërtimin e

²⁸ AMAE në AIH, Fondi: Serie Politica “P” (1891–1916), Pacco 674, image 7287, 7288, 7289. Telegram i ambasadorit italian në Athinë Carlotti dërguar Ministrisë së Jashtme, Athinë, 6 mars 1912.

²⁹ *Dokumente franceze për Shqipërinë dhe shqiptarët më 1912*, zgjedhi, përgatiti dhe redaktoi prof. dr. Muhamet Shatri, Instituti i Historisë-Prishtinë, Prishtinë: KGT, 2004, f. 73. Telegram i ambasadorit francez pranë Portës së Lartë dërguar Parisit, 8 shkurt 1912.

^{*} *Maz-har Beu*, vali i Kosovës.

^{**} *Halil Rexhai Beu*, nënkolonel i Shtatmadhërisë, shef i i Seksionit në Departamentin e Xhandarmërisë.

^{***} *Buharedin Beu*, inspektor rrugësh në Ministrinë e Punëve Botërore.

^{****} *Masar Beu*, shef i Departamentit të çështjeve Penale në Ministrinë e Drejtësisë.

^{*****} *Xhevdet Beu*, i deleguar për të studiuar reformat shkollore në Shqipërinë e Veriut.

^{*****} *Hajdar Beu* inspektor i Ministrisë së Brendshme.

^{*****} *Bedri Nuri Beu*, funksionarë në Ministrinë e Arsimit.

^{*****} *Osman Beu*, këshilltar në Ministrinë e Brendshme.

³⁰ Lista e personave që shoqëruan Komisionin për Reformat marrë nga: Muhamet Shatri, *Kryengritja e Përgjithshme shqiptare kundërosmane e vitit 1912*, Prishtinë: Libri shkollor “Prishtinë”, 2016, f. 60.

³¹ S. Skëndi, *Zgjidhimi kombëtar shqiptar ...*, f. 382.

godinave ushtarake; riparimin apo rindërtimin e godinave institucionale; në infrastrukturën rrugore dhe shumë investime të tjera të domosdoshme që do të shërbenin në rritjen e nivelit të jetesës së shqiptarëve.

Ambasadori italian Carlotti informonte ministrin e Jashtëm, San Giuliano-n për optimizmin që i kishte shfaqur ministri osman i Punëve Publike, Xhavid Beu lidhur me investimet që do të kryheshin në viset shqiptare. Në raportin e tij, Carlotti informonte edhe për takimin që kishte zhvilluar ministri Xhavid Beu me një bankieri me shumë influencë në Stamboll dhe për faktin se qeveria kishte alokuar 250 mijë lira turke për ndërtimin e rrugëve kryesore më problematike. Të tilla konsideroheshin: rruga Prizren-Shkodër që parashikohej të fillonte në muajin prill 1912; të përfundojnë rrugët ushtarake në Manastir dhe hekurudha Shkup-Gostivar.³² Komisionit i ishin vënë në dispozicion fonde të mëdha për problemet e arsimit dhe të ndërtimeve, për të zbutur opinionin publik dhe për të përfituar shqiptarët.³³

Xhavid Beu ishte shprehur optimist në efektin paqësues që ndërmarrjet e mësipërme do të kishin tek shqiptarët. Ai i shikonte ato si një mundësi e mirë punësimi për hapjen e shumë vendeve të punës me një pagesë shumë të mirë. Gjithashtu, ministri osman kishte bindje të padiskutueshme në suksesin e komisionit të Haxhi Adil Beut³⁴. Në përpjekje për të fituar besimin e shqiptarëve, në prag të nisjes së “Komisionit për Reformat”, qeveria mori dy vendime të rëndësishme. I pari kishte të bënte me shtyrjen e thirrjes së parlamentit nëse Komiteti “Bashkim e Përparim” nuk fitonte shumicën në zgjedhjet e pranverës. Vendimi i dytë kishte si qëllim të ndërronte qasje ndaj shqiptarëve, duke mos përdorur më forcën, por me anën e të hollave të konsiderueshme, të bëheshin për vete krerët dhe paria shqiptare. Në mbështetje të këtij vendimi, qeveria osmane caktoi një fond prej 50.000 lira turke për shpenzimet e reformave për çdo vilajet.³⁵

³² AMAE në AIH, Fondi: Serie Politica “P” (1891-1916), Pacco 674, image 7287, 7288, 7289. Telegram i ambasadorit italian në Athinë Carlotti dërguar Ministrisë së Jashtëm, Athinë, 6 mars 1912.

³³ Sulejman Kylçe, *Shqipëria në historinë osmane*, Tiranë: Globus R, 2004, f. 220.

³⁴ AMAE në AIH, Fondi: Serie Politica “P” (1891-1916), Pacco 674, image 7287, 7288, 7289. Telegram i ambasadorit italian në Athinë Carlotti dërguar Ministrisë së Jashtëm, Athinë, 6 mars 1912.

³⁵ AIH, A-IV-10, Carl Ritter von Sachs, “Historia e tatëpjetës së Turqisë (pjesa që i përket Shqipërisë)”, Wien: 1913, f. 23.

Haxhi Adil Beu u autorizua për zbatimin e reformave dhe për të shpërndarë të holla tek shqiptarët, me justifikimin se ato po shpërndaheshin për të kompensuar dëmet e shkaktuara nga ushtria në vitet e shkuara.³⁶ Komisioni, i cili ngutej të arrinte në vilajetet e Rumelisë para zhvillimit të zgjedhjeve, synonte të forconte administratën dhe xhandarmërinë në viset shqiptare.³⁷ Krahas kompetencave të pakufizuara, ministrit iu dhanë edhe 200.000 lira turke për të korruptuar prijësit shqiptarë për të mbështetur komitetin “Bashkim e Përparim” në zgjedhjet e ardhshme.³⁸ Haxhi Adil Beut i ishin vënë në dispozicion edhe 12.000 lira turke për të plotësuar të gjitha kërkesat e shqiptarëve për dëmshpërblimet e pretenduara të vitit të kaluar, përfshirë edhe ato të klerit për orenditë e kishës dhe të famullive. Krahas angazhimeve të komisionit për reformat, edhe Asim Beu që mbante postin e ministrit të Jashtëm kishte urdhëruar guvernatorët e vilajeteve shqiptare që të trajtonin me butësi popullin shqiptar. Sipas informacioneve që ai kishte, vilajeti i Kosovës ishte më problematiku dhe për këtë i kishin tërhequr vërejtje ministrit edhe diplomatët e huaj.³⁹ Valiu duhet të dëgjonte ankesat e popullit dhe të bënte ç’është e mundur që të shuajë pakënaqësitë dhe të përpiqet të ftojë krerët në bisedime. Pra, në dukje qeveria shfaqej sikur kërkonte të jetë pranë ankesave dhe shqetësimeve të shqiptarëve me synim qetësimin e situatës dhe të armiqësive.

Qëndrimi i qarqeve diplomatike dhe dyshimet e tyre në suksesin e Komisionit të Haxhi Adil Beut

Lajmi rreth udhëtimit të ministrit të Brendshëm për në vilajetet e Rumelisë pati jehonë të gjerë edhe në qarqet diplomatike. Qëndrimet e tyre ndaj “Komisionit për Reforma” ishin të ndryshme dhe në disa raste shfaqnin dyshime si në suksesin ashtu dhe në misionin e vërtetë të ministrit osman. Kishte nga ata që ishin shprehur se misioni i vërtetë i Haxhi Adil Beut ishte parandalimi i shpërthimit të kryengritjes së armatosur të shqiptarëve, me anë të premtimeve fiktive si edhe

³⁶ R. Abdyli, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare (1911-1912) ...*, Libri 2, f. 165.

³⁷ S. Skëndi, *Zgjidhjet kombëtare shqiptare ...*, f. 383; M. Shatri, *Kryengritja e Përgjithshme Shqiptare ...*, f. 61.

³⁸ R. Abdyli, *Lëvizja Kombëtare shqiptare (1911-1912) ...*, Libri 2, f. 166.

³⁹ M. Shatri, *Kryengritja e Përgjithshme Shqiptare ...*, f. 35.

propagandimi i kandidatëve të Komitetit “Bashkim e Përparim” dhe pengimi i zgjedhjes së kandidatëve kombëtarë shqiptarë.⁴⁰

Sipas ambasadorit italian në Berlin, Pansa, njoftonte se në Gjermani kishte mbërritur lajmi se një komision i posaçëm për reformat do të udhëtojë për në vilajetet shqiptare për të parë gjendjen nga afër. Në njoftim thuhet se në Gjermani “ka shumë pak besim se ky komision do të rezultojë i suksesshëm dhe i qëndrueshëm”.⁴¹ Po ashtu, më 5 shkurt 1912 diplomati italian Avarna, njoftonte Ministrinë e Jashtme të Italisë për nisjen e komisionit nga Stambolli për në vilajetet shqiptare dhe për dyshimet që kishte Austro-Hungaria në suksesin e Haxhi Adil Beut.⁴²

Edhe Rusia dukej se ishte skeptike për punën e Komisionit. Sekretari i Parë i legatës italiane në Cetinë Pignatti, njoftonte Ministrinë e Jashtme se kryeministri i Rusisë ishte shprehur se diplomatët rusë nuk e kishin njoftuar për komisionin që do të vizitonte Shqipërinë. Por kryeministri shtonte se kishte pak besim në masa të kësaj natyre sepse edhe në të shkuarën kishin rezultuar të paefektshme.⁴³

Në janar të vitit 1912, Greqia kishte deklaruar zyrtarisht se mbështeste opozitën në Perandorinë Osmane,⁴⁴ sepse trazirat që do të shkaktoheshin brenda Perandorisë e vinin në pikëpyetje jetëgjatësinë e qeverisë osmane dhe se ajo mund të përfitonte nga situata e destabilizuar për të arritur synimet e saj ekspansioniste. Pavarësisht se grekët u shprehën hapur se nuk e mbështesnin Komitetin “Bashkim e Përparim”, këtë taktikë e kishte dënuar Patriku i Përgjithshëm.⁴⁵ Trazirat që mund të krijoheshin larg kufirit gjeografik nuk përbënin preokupim për Greqinë.

⁴⁰ R. Abdyli, *Lëvizja Kombëtare shqiptare (1911-1912) ...*, Libri 2, f. 164.

⁴¹ AMAE në AIH, Fondi: Serie Politica “P” (1891-1916), Pacco 674, image 6926. Telegram i ambasadorit italian në Berlin, Pansa, dërguar Ministrisë së Jashtme, Berlin, 1 shkurt 1912.

⁴² *Po aty*, image 6897. Telegram i ambasadorit italian në Vjenë, Avarna, dërguar Ministrisë së Jashtme, Vjenë, 5 shkurt 1912.

⁴³ *Po aty*, image 6898. Telegram i sekretarit të Parë të legatës italiane në Cetinë, Pignatti, dërguar Ministrisë së Jashtme të Italisë, Cetinë, 8 shkurt 1912.

⁴⁴ Ledia Dushku, “Ismail Qemali, Greqia dhe kryengritja shqiptare e vitit 1912”, *Pavarësia e Shqipërisë dhe sfidat e shtetit shqiptar gjatë shek. XX*, Konferencë shkencore me rastin e 90-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë (27 nëntor 2007), përgatiti për botim dhe redaktor shkencor M. Verli, Universiteti i Tiranës, Instituti i Historisë, Tiranë: Klean, 2007, f. 93.

⁴⁵ M. Shatri, *Kryengritja e Përgjithshme Shqiptare ...*, f. 27.

Dyshime kishte hedhur edhe konsulli bullgar në Shkup, duke theksuar se ndonëse zyrtarisht ishte shpallur se do të vizitonte vilajetet e Rumelisë, në fakt objektivi kryesor i Komisionit të Reformave ishte të vizitonte vilajetet shqiptare ku kishin filluar trazirat dhe të ndërmerre masat e duhura me baza të forta për të mbrojtur pjesët e tjera të Rumelisë.⁴⁶

Udhëtimi i “Komisionit për Reformat” në vilajetet shqiptare

Për suksesin e Komisionit, me në krye Haxhi Adil Beun pati mjaft dyshime paraprake krahas qarqeve diplomatike, edhe nga ana e shqiptarëve. Një motiv i fortë, që ngjallte dyshime në misionin e Haxhi Adil Beut ishin edhe precedentët e krijuar në moszbatimin e reformave të premtuara.

Korrespondenti i mirënjohur i gazetës “The Times” James Bouchier, i sapo kthyer nga një qëndrim i gjatë në Turqi dhe në shtetet Ballkanike, shprehej se “shqiptarët kanë ngelur shumë herë të zhgënjyer në shpresat e dhëna nga qeveria osmane për përmirësimin e gjendjes së tyre dhe tashmë nuk besojnë në sinqeritetin e premtimeve qeveritare”. Sipas tij, shqiptarët synojnë që nëpërmjet presioneve dhe kërcënimeve të ndryshme të arrijnë të përfitojnë lëshime nga Porta e Lartë.⁴⁷ Bouchier shton se situata do të mbetë e qetë atë vit edhe në zonat e Malësisë që njihej si vatra e revoltës. Qetësia i atribuohet prezencës së Komisionit për Reformat, veçanërisht pjesëmarrjes së të huajve në të, pa anashkaluar edhe shpërndarjen e parave prej tij.

Në një takim të Hasan Prishtinës me konsullin austro-hungarez në Selanik, ai kishte evidentuar se sundimi i ashpër xhonturk shfaqej kudo në viset shqiptare dhe nuk besonte që qeveria do t'i vinte në jetë kërkesat e shqiptarëve, duke paralajmëruar shpërthimin e një tjetër revolte.⁴⁸

Edhe Ismail Qemal Vlora e ndiqte me shumë kujdes lëvizjen shqiptare dhe udhëtimin e ministrit Haxhi Adil Beu. Në një takim që kishte zhvilluar me diplomatin italian Pompeo Aloisi, ai ishte shprehur se

⁴⁶ R. Abdyli, *Lëvizja Kombëtare shqiptare (1911-1912) ...*, f. 164.

⁴⁷ AMAE në AIH, Fondi: Serie Politica “P” (1891 – 1916), Pacco 674, image 7287, 7288, 7289. Telegram i ambasadorit italian në Athinë, Carlotti, ku njoftonte Ministrinë e Jashtme mbi vazhdimin e premtimeve fiktive të Portës së Lartë kundrejt shqiptarëve, Athinë, 6 mars 1912.

⁴⁸ S. Skëndi, *Zgjimi kombëtar shqiptar ...*, f. 381.

nuk kishte besim në reformat e ministrit të Brendshëm, përkundrazi situata ishte përkeqësuar si rrjedhojë e udhëtimit të komisionit dhe revoltat kishin shpërthyer.⁴⁹

Për shkak të situatës së pasigurtë, ministri i Brendshëm kërkoi që komisioni të shoqërohej nga një numër i konsiderueshëm forcash sigurie. Komisioni, i nisur nga Selaniku mbërriti më 23 shkurt 1912 në (Qyprilia), vilajetin e Kosovës, ku thirri në takim funksionarët kryesorë të Shtipit dhe anëtarë të gjykatës ushtarake me qëllim që të njihet me gjendjen administrative e politike të vendit.⁵⁰ Por, nga ana e popullsisë, si ajo e krishterë dhe ajo myslimane nuk ka dërguar asnjë delegacion tek ministri, për t'i shprehur ankesat e as dëshirat.

Pas një vizite të shkurtër 24 orëshe ndalesa e radhës ishte Shkupi. Komisioni u prit nga Komiteti “Bashkim e Përparim”. Në vizitën katër ditore në Shkup, komisioni vizitoi disa dikastere të ndryshme. Ministri i Brendshëm takoi të burgosurit me kombësi të ndryshme dhe dëgjoi ankesat e tyre të ndryshme. Ai premtoi se gjykata do të shqyrtojë me shumë kujdes dosjet e secilit prej tyre dhe se ata do të liroheshin në të ardhmen. Sipas konsullit të Francës në Shkup pohonte se, Mazhar Beu kishte vizituar dy herë burgun e Shkupit dhe kishte arritur të zbulojë se drejtori i institucionit kishte keqtrajtuar disa të burgosur. Për këtë arsye, ministri ishte shprehur se do të marrim masa⁵¹.

Më datë 24 shkurt 1912, ministri arriti në Shkup. Gjatë qëndrimit në Shkup, Haxhi Adil Beu vizitoi edhe klubin “Bashkim e Përparim”. Në takimin që zhvilloi me drejtuesit e Komitetit në Shkup, ministri diskutoi për organizimin e zgjedhjeve parlamentare dhe kërkoi angazhimin e plotë të tyre.⁵² Në konakun ku qëndroi ministri në Shkup nuk pati asnjë delegacion që shkoi për të biseduar me të, përveç mitropolitit serb që i kishte paraqitur një memorandum.⁵³ Takimin e radhës ai e zhvilloi me

⁴⁹ AMAE në AIH, Fondi: Serie Politica “P” (1891 – 1916), Pacco 674, image P1010084-P1010088. Telegram i ambasadorit italian në Paris Tittoni dërguar ministrit të Jashtëm të Italisë San Giuliano mbi një takim të bërë nga bashkëpunëtori i tij Aloisi me Ismail Qemalin, Paris, 31 maj 1912.

⁵⁰ *Dokumente franceze për Shqipërinë dhe shqiptarët më 1912...*, (Prishtinë: 2004), f. 102. Telegram i konsullit francez në Shkup dërguar ambasadorit të Francës pranë Portës së Lartë, Shkup 29 shkurt 1912.

⁵¹ *Po aty*.

⁵² R. Abdyl, *Lëvizja Kombëtare shqiptare (1911-1912) ...*, Libri 2, f. 166.

⁵³ *Dokumente franceze për Shqipërinë dhe shqiptarët më 1912...*, (Prishtinë: 2004), f. 102. Telegram i konsullit francez në Shkup dërguar ambasadorit të Francës pranë

banorët e Shkupit, ku pjesëmarrja ishte tepër e ulët. Ministri i Brendshëm bëri propagandë të madhe politike dhe iu kërkoi që të mos rizgjedhin deputetë shqiptarët kundërshtarë të betuar të Komitetit “Bashkim e Përparim”⁵⁴, duke përmendur emrat e Hasan Beut (Prishtina) dhe Nexhib bej Draga⁵⁵. Përpjekjet e tij për të forcuar xhandarmërinë ishin të vazhdueshme. Për këtë koloneli Fulon i mbështetur edhe nga Gravez ishin përpjekur të bindin ministrin se do t’ia vlente më shumë që të kishte vetëm oficerë francezë për riorganizimin e xhandarmërisë.⁵⁶ Para se të largohej nga Shkupi, Haxhi Adil Beu iu kishte kërkuar mbështetje shqiptarëve, por ata e kishin refuzuar. Ministri u largua i zhgënjyer dhe u nis drejt Prishtinës për një qëndrim treditör. Komisioni u prit nga titullarët e lartë të autoriteteve civile dhe ushtarake te qeverisë si dhe nga disa miq personalë të ministrit të Brendshëm.⁵⁷

Gjatë qëndrimit në Prishtinë, Haxhi Adil Beu u vizitua kryesisht nga personalitete zyrtare. Mitropoliti Sava dhe titullarë të tjerë serbë i dorëzuan ministrit një listë të gjatë të vrasjeve të serbëve si dhe kërkesën për vendosjen e kabanave në kishën e Prishtinës, të Gjilanit dhe të Lipjanit.⁵⁸ Nga paria shqiptare e besimit mysliman shkuan në audiencë, kryetari i Bashkisë dhe i Gjyqit, Jusuf Peçi e Sadik Halaxhi, të shoqëruar nga tarafi i tyre.⁵⁹ Edhe në Prishtinë pritja e ministrit nga pala shqiptare ishte e ftohtë dhe pjesëmarrja e ulët, përveç disa kureshtarë. Gjatë qëndrimit në Prishtinë ministri u përpoq të bëjë për vete shqiptarët duke

Portës së Lartë, Shkup 29 shkurt 1912. Telegram i konsullit francez në Shkup dërguar ambasadorit të Francës pranë Portës së Lartë, Shkup 29 shkurt 1912, f. 102.

⁵⁴ M. Shatri, *Kryengritja e Përgjithshme Shqiptare ...*, f. 63.

⁵⁵ *Dokumente franceze për Shqipërinë dhe shqiptarët më 1912*, vëll. II, përgatiti për botim Muhamet Shatri, Tiranë: Toena, 2012, f. 30-31. Njoftim i konsullit të Francës në Shkup për Shkëlqesinë e tij, zotin Poincaré, kryeministër dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Shkup, 5 mars 1912.

⁵⁶ *Dokumente franceze për Shqipërinë dhe shqiptarët më 1912...*, (Prishtinë: 2004), f. 102. Telegram i konsullit francez në Shkup dërguar ambasadorit të Francës pranë Portës së Lartë, Shkup 29 shkurt 1912, f. 102-103. Telegram i konsullit francez në Shkup dërguar ambasadorit të Francës pranë Portës së Lartë, Shkup 29 shkurt 1912.

⁵⁷ *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze ...*, vëll. I, f. 346. Raport i zëvendëskonsullit Pozel nga Mitrovica, drejtuar kontit Berchtold, Mitrovicë, 15 mars 1912.

⁵⁸ M. Shatri, *Kryengritja e përgjithshme shqiptare ...*, f. 66.

⁵⁹ *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1912)...*, vëll. I, f. 346. Raport i zëvendëskonsullit Pozel nga Mitrovica, drejtuar kontit Berchtold, Mitrovicë, 15 mars 1912.

shpërndarë para për ta si dhe për godinat. Pasi vizitoi shkollat në Prishtinë, ai dhuroi para për nxënësit e varfër⁶⁰, seminaristët dhe mësuesit e seminarit, për meremetimin e zyrave të administratës si dhe të medreseve e xhamive.⁶¹ Gjithashtu, ai u premtoi edhe ndihma të tjera në të ardhmen.

Pasi la Prishtinën ministri udhëtoi për në Mitrovicë. Komisioni u prit nga autoritetet civile e ushtarake si dhe nga disa nxënës shkollash turke e serbe. Në pritje pati edhe kureshtarë të tjerë që nuk shfaqën ndonjë entuziazëm të madh. Nga paria shqiptare dhe serbe nuk kishte dalë asnjë në pritje.⁶² Ndonëse shqiptarët katolikë u këshilluan nga konsulli austro-hungarez që të vepronin si komunitet e tjera, por ata nuk pranuan të marrin pjesë në audiencën e ministrit⁶³. Ai vizitoi edhe ndërtesat qeveritare. Pasi pa nga afër gjendjen e tyre të rrënuar, Haxhi Adil Beu u detyrua të jepte 3000 lira për ngritjen e një ndërtese të re. Nga përfaqësuesit e huaj diplomatikë, ministri kishte pritur konsullin rus, i cili kishte parashtruar ankesën për shtypjen e serbëve nga ana e “arnautëve”. Ministri kishte pritur në takim edhe zëvendëskonsullin e Austro-Hungarisë në Mitrovicë, Pözel, me të cilin kishte biseduar rreth gjendjes së popullsisë dhe nevojave emergjente të tyre. Në takim ministri osman kishte shpalosur edhe projektin që komisioni kishte për Mitrovicën.⁶⁴

Ashtu siç pritej, udhëtimi i Komisionit kishte hasur probleme në aksin rrugor Gjakovë - Prizren. Një bandë shqiptare me më shumë se 1000 persona mori pjesë në sulm⁶⁵. Sipas ministrit fuqiptotë italian në Sofje, Bosdari, raportohet se “ndërsa ministri i Brendshëm bashkë me komisionin po shkonte nga Gjakova për në Prizren, një bandë e fortë shqiptare ka sulmuar patrullën që e shoqëronte”. Sulmi rezulton të kishte qenë shumë i ashpër, me shkëmbime zjarri dhe për pasojë nga patrulla

⁶⁰ M. Shatri, *Kryengritja e Përgjithshme Shqiptare ...*, f. 66.

⁶¹ *Po aty*, f. 68.

⁶² *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze ...*, vëll. I, f. 348. Raport i zëvendëskonsullit Pozel nga Mitrovica, drejtuar kontit Berchtold, Mitrovicë, 15 mars 1912.

⁶³ M. Shatri, *Kryengritja e përgjithshme shqiptare ...*, f. 71.

⁶⁴ Për programin e diskutuar shih telegramin e zëvendëskonsullit austro-hungarez, Pözel nga Mitrovica derguar kontit Berchtold, në *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze ...*, vëll. I, f. 348-349.

⁶⁵ *AIH*, A-IV-10, Carl Rittervon Sachs, “Historia e tatëpjetës së Turqisë ...”, f. 23.

kishte patur 7 të vdekur dhe 3 të plagosur.⁶⁶ Por mendohej se numri i viktimave mund të ishte edhe më i madh. Autoritetet osmane dërguan përfaqësues për të biseduar me shqiptarët por ata u përgjigjen se nuk kanë asnjë besim tek kjo qeveri. Nën udhëheqjen e Hasan Prishtinës, shqiptarët kërkonin armët e dorëzuara, largimin nga detyra të drejtuesve dhe të heqin dorë nga çelja e shkollave turke⁶⁷. Sipas diplomatit italian, sulmi dukej se ishte drejtuar kundër ministrit të Brendshëm, por atij nuk i kishte ndodhur gjë, dhe kishte mbërritur i paprekur së bashku me komisionin në Prizren. Në lidhje me suksesin e punës së komisionit, ai shprehet se deri tani rezultati i Komisionit të Reformave ka qenë tërësisht negativ.⁶⁸

Menjëherë u dërguan dy batalione përforcime nga Shkupi për në Prizren për të garantuar sigurinë e Haxhi Adil Beut dhe të komisionit që e shoqëronte.⁶⁹ Në këto rrethana të frikshme rezulton se komisioni qëndroi në Pejë dhe u kërkuan përforcime të tjera.⁷⁰ Pavarësisht problemeve që hasi nga çetat shqiptare në vilajetin e Kosovës, ministri i Brendshëm nuk u tërhoq nga misioni i tij. Komisioni vijoi udhëtimin për në vilajetin e Shkodrës. Por gjatë rrugës ai ishte sulmuar nga shqiptarët. Ky fakt evidentohet në raportin e legatës italiane në Sofje, dërguar ministrit San Giuliano, sipas të cilit udhëtimi kishte qenë i tensionuar sepse komisioni ishte sulmuar pranë urës së Vezirit nga çeta e Mahmut Zaimit, e njëjta që e kishte sulmuar edhe më parë pranë Gjakovës.⁷¹ Por sulmi rezultoi i pasuksesshëm dhe Komisioni vijoi udhëtimin për në Shkodër. Eskortës iu shtuan masat e sigurisë por përsëri pësoi një sulm tjetër.

Agresioni tjetër i ashpër ndodhi pranë fshatit Istigian (krahinë e Lumës). Sulmi u krye nga një bandë shqiptare dhe pati luftime të

⁶⁶ *AMAE* në *AIH*, Fondi: Serie Politica "P" (1891 – 1916), Pacco 674. Telegram i datës 13 mars 1912 i ministrit Fuqplotë të Italisë në Sofje, Bosdari, dërguar Ministrisë së Jashtme të Italisë.

⁶⁷ *AIH*, A-IV-10, C. Ritter von Sachs, "Historia e tatëpjetes se Turqisë...", f. 23.

⁶⁸ *AMAE* në *AIH*, Fondi: Serie Politica "P" (1891 – 1916), Pacco 674, image 7342. Ministri Fuqplotë italian në Sofje, Bosdari, njofton Ministrinë e Jashtme, Sofje, 13 mars 1912.

⁶⁹ *Po aty*.

⁷⁰ *Po aty*, image 7334. Në raportin e ministrit Fuqplotë italian në Beograd, Baroli, dërguar për Ministrinë e Jashtme të Italisë raportohet për frikën e sulmeve të tjera ndaj komisionit.

⁷¹ *Po aty*, image 7121-7123. Raport i përgjithshëm i legatës italiane në Sofje dërguar ministrit të Jashtëm, Sofje, 23 mars 1912.

ashpra.⁷² Kjo krahinë e Kosovës ishte një ndër më problematiket e vilajeteve shqiptare dhe autoritetet nuk ia kishin dalë të vendosnin plotësisht rend dhe qetësi. Bandat kishin sulmuar pranë një fshati të Gjakovës mytesarifin e Pejës, i cili po kthehej nga Prizreni, ku kishte shoqëruar ministrin. Nga shkëmbimi i zjarrit kishin mbetur të vrarë një zyrtar dhe 8 ushtarë të eskortës.⁷³

Situata e tensionuar detyroi ministrin e Brendshëm të ftojë në Prizren disa prej krerëve të Lumës, ku dallohen Mustafa Lita, Hysen Daci dhe Ramadan Zaskoci.⁷⁴ Në takim morën pjesë Mustafa Lita dhe Hysen Daci, ndërsa Ramadan Zaskoci qëndroi i arratisur në male. Për të siguruar mbështetjen e tyre, ministri iu premtoi amnisti të plotë dhe shuma të konsiderueshme parash. Në raportin e legatës italiane në Sofje dërguar San Giulianos pohohet se ministri i kishte dhënë Mustafa Litës 1000 lira turke si dëmshpërblim për dëmet e shkaktuara nga ushtarët osmanë në Lumë. Lita kishte pranuar ta shoqëronte Komisionin nën “besën” e tij, për të arritur në Shkodër.⁷⁵ Shuma e dhënë nuk ishte vetëm për të shlyer dëmet e shkaktuara nga ushtria osmane por edhe si një kompromis për të evituar ndonjë sulm tjetër të mundshëm në krahinën e Lumës.

Pas takimit, Komisioni, u nis nga Prizreni për në Shkodër, ku udhëtoi nëpër Pukë dhe Mjedë me masa të forta sigurie. Ai kishte urdhëruar shtimin e trupave të sigurisë edhe në qytetin e Shkodrës. Referuar telegramit të Barolit dërguar San Giuliano-s numri i tyre kishte arritur në rreth 15 mijë ushtarë.⁷⁶ Edhe pse ishin marrë masat e nevojshme sigurie, eskorta e ministrit u përball me një sulm para se të hynte në qytet. Konsulli austro-hungarez në Shkodër Zambaur njoftonte ministrin e Jashtëm Berchtold se eskorta e ministrit ishte përballur me një sulm të ashpër të shqiptarëve para se të hynte në qytetin e Shkodrës.⁷⁷ Pavarësisht incidenteve të ndryshme, komisioni arriti në qytetin e Shkodrës dhe u prit me nderime ushtarake. Në pritje dolën edhe drejtuesit

⁷² *Po aty.*

⁷³ *Po aty.*

⁷⁴ M. Shatri, *Kryengritja e Përgjithshme Shqiptare ...*, f. 83.

⁷⁵ *AMAE* në *AIH*, Fondi: Serie Politica “P” (1891 – 1916), Pacco 674, image 7121-7123. Raport i përgjithshëm i legatës italiane në Sofje dërguar ministrit të Jashtëm, Sofje, 23 mars 1912.

⁷⁶ *Po aty*, image 7353. Telegram i ministrit Fuqiplotë italian në Beograd, Baroli, dërguar Ministrisë së Jashtme, Beograd, 19 mars 1912

⁷⁷ *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze*, vëll. I, f. 391. Raport i konsullit Zambauer nga Shkodra, drejtuar kontit Berchtold, Shkodër, 25 mars 1912.

e administratës. Pritja nga ana e popullatës si katolike ashtu edhe myslimane rezultoi të ketë qenë e ftohtë, edhe ata që kishin dalë ishin kryesisht kureshtarë e jo simpatizantë.

Në Shkodër ministri i Brendshëm osman kishte pritur edhe konsullin francez. Në takim Haxhi Adil Beu i kishte shprehur diplomatit të lartë mirënjohje për këshillat e dhëna malësorëve dhe pastaj i kishte kërkuar mendim për masat që duhej të ndërmerre për të qetësuar popullatën e këtij vilajeti. Diplomati francez i kishte sugjeruar ministrit të Brendshëm që: a) të ftonte në bisedime prijësit e Malësisë; b) të përpiquej të fitonte besimin e tyre; c) të këmbëngulte para malësorëve se qeveria kishte vendosur të shqyrtonte me dashamirësi shkaqet e pakënaqësive; d) të përkrahte kërkesat e tyre të njohura në marrëveshjen e Podgoricës. Në parim ministri osman kishte pranuar se Porta e Lartë duhej të ishte përpjekur të plotësonte disa kërkesa të shqiptarëve dhe mos ta tepronte në mbledhjen e taksave të reja. Ai kishte premtuar se sugjerimet e konsullit francez do të shqyrtoheshin nga ekspertët e fushave përkatëse.⁷⁸ Kjo përfordhet edhe në relacionin e diplomatit italian dërguar ministrit të Jashtëm San Giuliano, sipas të cilit komisioni ishte i gatshëm të dëgjonte propozimet e shqiptarëve.⁷⁹

Haxhi Adil Beu pati takime me krerët e komunitetit mysliman. Ai pati marrëdhënie me Hasan Efendi Bekteshin, kryetarin e Xhemijetit të Shkodrës. Ministri dha 1000 lira turke për ngritjen e një medreseje në Shkodër.

Nga ana tjetër, ministri u kujdes të bënte për vete popullsinë. Në një dëgjese me malësorë ku merrte pjesë edhe kajmekami i Tuzit, ministri kishte vendosur t'u jepte një pjesë të madhe të dëmshpërblimeve të një viti më parë. U dhanë 7.000 lira për të blerë farën për të siguruar mbjelljen e tokave për të gjitha kategoritë e popullsisë të këtij vilajeti duke ngritur tre komisione në Tuz, Lezhë dhe Krujë.⁸⁰ Për arsimin

⁷⁸ *Dokumente franceze për Shqipërinë dhe shqiptarët më 1912 ...*, vëll. II, f. 45. Njoftim i konsullit të Francës në Shkodër për Shkëlqesinë e tij zotin Poincare, Shkodër, 20 mars 1912.

⁷⁹ *AMAE në AIH*, Fondi: Serie Politica "P" (1891 – 1916), Pacco 674, image 7408. Telegram i nënkonsullit italian në Korfuz, Labia, dërguar Ministrisë së Jashtme, Korfuz, 26 mars 1912.

⁸⁰ *Dokumente ruse për lëvizjen kombëtare shqiptare më 1912*, përgatiti Muhamet Shatri, Ramiz Abdyl, Prishtinë: Prishtinë KGT, 2006, f. 70. Telegram i nënkonsullatës së Perandorisë të Rusisë në Shkodër dërguar Ministrisë së Jashtme në Sankt Petersburg, Shkodër, 24 mars/6 prill 1912.

komisioni mori vendim se do të ndërtohen shkolla dhe konvikte në zona të ndryshme të vilajetit të Shkodrës.⁸¹ Gjithashtu, ai kishte urdhëruar restaurimin e gurëve të varrezave dhe të shkollave në bajraçe të Malësisë.⁸²

Komisioni në qëndrimin e tij në Shkodër ishte përpjekur të zvogëlonte sa më shumë të ishte e mundur ndikimin e klerit katolik tek popullata e Malësisë dhe të mbante larg kryepeshkvin Jak Serreqi.⁸³ Ndoshta ky mund të ketë qenë edhe motivi që Ministria e Punëve të Jashtme austro-hungareze kishte udhëzuar ambasadorin Pallavicini për të ndërhyrë pranë qeverisë osmane në favor të klerit katolik dhe imzot Serreqit. Udhëzimi ishte në formë miqësore dhe konfidenciale që t'i tërheqë vëmendje Asim Beut mbi qëndrimin që ka mbajtur "Komisioni i Reformave" karshi elementit katolik dhe imzot Serreqit. Në raport evidentohet se "në qoftë se malësorët, respektivisht kleri katolik, pëson zhgënjim në shpresën që ka në ardhjen e Haxhi Adil Beut, kjo gjë do t'i çelë portën intrigës së huaj në Shqipëri".⁸⁴

Dallimi mes katolikëve dhe myslimanëve shtonte pakënaqësitë e tyre ndaj qeverisë. Këto ia kishte konfirmuar Avarna-s edhe ministri i Jashtëm i Austro-Hungarisë, konti Berchtold duke i konfirmuar se, sipas informacioneve të ardhura nga konsujt austro-hungarezë, vihet re se pakënaqësia e katolikëve vjen si pasojë e dallimeve që bëjnë autoritetet lokale me myslimanët.⁸⁵

Me sugjerimin e konsullit austriak në Shkodër, imzot Serreqi kërkoi një audiencë prej Haxhi Adil Beut në të cilën u paraqit me peshkopin e Nënshatit imzot Kolecin dhe kryebatin e Mirditës, Doçin. Qëndrimi i ministrit me përfaqësuesit e episkopatës ishte i rezervuar, ai

⁸¹ *Po aty*, f. 71.

⁸² *Dokumente franceze për Shqipërinë dhe shqiptarët më 1912 ...*, f. 47-48. Njoftim i konsullit të Francës në Shkodër për Shkëlqesinë e tij zotin Poincare, Shkodër, 24 mars 1912.

⁸³ *Po aty*, f. 66. Njoftim i konsullit të Francës në Shkodër për Shkëlqesinë e tij zotin Poincare, Shkodër, 12 maj 1912.

⁸⁴ *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze, 1912 ...*, vëll. I, f. 394. Udhëzime të Ministrisë së Punëve të Jashtme drejtuar ambasadorit Pallavicini në Konstandinopojë, Vjenë, 26 mars 1912.

⁸⁵ *AMAE në AIH*, Fondi: Serie Politica "P" (1891-1916), Pacco 674, image 7887. Telegram i ambasadorit italian në Vjenë Avarna dërguar ministrit të Jashtëm San Giuliano mbi udhëtimin e komisionit për reforma me në krye ministrin e Brendshëm Haxhi Adil Beun, Vjenë, 4 prill 1912.

evitoi të merrej me hollësi të çështjeve aktuale politike dhe nuk u diskutua as për dëmshpërblimet e vitit të kaluar.⁸⁶

Gjatë qëndrimit të tij në Shkodër, ministri shkarkoi nga detyra valiun e emëruar para pak kohësh Hajri Pasha dhe emëroi në vend të tij komandantin ushtarak kolonel Hasan Riza Pashën, duke dashur të përqendrojë në një dorë drejtimin ushtarak e civil të këtij vilajeti. Po ashtu ai bëri emërimet e reja edhe në Drejtorinë e Arsimit⁸⁷. Ministri anuloi emërimin e kolonelit shqiptar Bajram Bej Curri në drejtimin e regjimentit të xhandarmërisë në Shkodër dhe urdhëroi ndarjen e regjimentit të këtij vilajeti në dy batalione, Shkodër dhe Durrës.⁸⁸

Në vendimin e nxjerrë nga valiun Nedin Beu, Preng Bib Doda administronte 12 bajraçet e Mirditës të ndara në tre kaza. Por, pas vizitës së Haxhi Adil Beut, influenza e princit të Mirditës u dobësua. Ministri shfuqizoi vendimin e valiut dhe urdhëroi ndarjen e re administrative, çka sillte automatikisht rënien e pushtetit të Preng Bib Dodës në një kajmekam të thjeshtë të pesë fiseve mirditase.⁸⁹

Gjatë takimeve që pati, ministri bëri premtime të shumta. Ai premtoi ndërtimin e 52 postave të xhandarmërisë; meremetime dhe investime rrugësh; ngritjen e disa shkollave dhe konvikteve; ndërtimin e një spitali në Shkodër, një farmaci, një ambulancë⁹⁰. U propozua që të kishte një vend mjeku në qendrat e kazave Tuz, Lezhë, Pukë dhe Orosh, ndërkohë që do të merrej ky vendim nëpër këto sanxhaqe do të vepronin dy mjekë, të cilët do të kryenin vizitat dhe do të shpërndanin medikamente falas.⁹¹ Aktiviteti propagandistik i Komisionit në Shkodër ishte referuar edhe në raportin e ambasadori italian në Vjenë, Avarna. Në të ai shprehej se: komisioni është dërguar për të mbledhur informacione për gjendjen e popullit shqiptar në interes të reformave, por nuk ka bërë

⁸⁶ *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1912)...*, vëll. I, f. 409. Telegram i konsullit Zambauer nga Shkodra, drejtuar eprorëve të tij në Vjenë, Shkodër, 31 mars 1912.

⁸⁷ *Po aty*, f. 399. Telegram i konsullit Zambauer nga Shkodra, drejtuar Ministrisë së Jashtme, Shkodër, 28 mars 1912.

⁸⁸ *Po aty*, f. 412. Telegram i konsullit Zambauer nga Shkodra, drejtuar eprorëve të tij në Vjenë, Shkodër, 31 mars 1912.

⁸⁹ *Po aty*.

⁹⁰ *Po aty*, f. 413.

⁹¹ M. Shatri, *Kryengritja e përgjithshme shqiptare kundërosmane...*, f. 89.

gjë tjetër veçse premtime dhe ka propaganduar që këta të zgjedhin në zgjedhjet e ardhshme kandidatët e xhonturqve.⁹²

Nga Shkodra Komisioni i Reformave kishte udhëtuar nëpër Lezhë për të arritur në Tiranë. Në qëndresën që kishte patur në Lezhë, ministri kishte bërë disa premtime si hapjen e disa shkollave fillore, shpërblimin me 12.000 lira të dëmeve të shkaktuar nga Shefqet Turgut Pasha, si dhe investime në rrugë dhe në përmirësimin e jetesës. Malësorët i deklaruan se ata do të presin edhe dy javë për përmbushjen e premtimeve.⁹³ Delegacioni arriti në Tiranë i shoqëruar nga Esat Pasha, ku nuk mungoi pritja zyrtare dhe parada e fëmijëve. Ministri dhe Esati, ndër të tjera biseduan edhe për çështjen e deputetit ku ranë në ujdi: “Esadi do të shkonte në Stamboll për tu bërë anëtar i një Komisioni të Ministrisë së Luftës dhe pas kësaj do të hiqte dorë nga pozita si deputet i sanxhakut të Durrësit”.⁹⁴

Komisioni u shoqërua nga Esad Pasha në rrugëtimin Tiranë-Elbasan.⁹⁵ Nga frika e ndonjë incidenti, Ai e shoqëroi me 30 persona të armatosur deri në Elbasan.⁹⁶ Pasi arriti Ministri Haxhi Adil Beu ka asistuar në hapjen e shkollës shqiptare në Elbasan dhe ka dhuruar nga ana e qeverisë një shumë prej 700 lira turke.⁹⁷ Komisioni përpiquej të tregohej bashkëpunues me shqiptarët duke synuar të fitojë mbështetjen e tyre.

Në telegramin nr. 198 të datës 12 prill 1912 të Labia-s thuhet se edhe nga Elbasani për në Berat komisioni u shoqërua nga shqiptarët. Në vijim të dokumentit, diplomati italian e përmbyll me njoftimin se, komisioni gjithkund ku ka shkuar ka bërë të njëjtat premtime të cilat janë

⁹² AMAE në AIH, Fondi: Serie Politica “P” (1891 – 1916), Pacco 674, image 7393. Telegram i ambasadorit italian në Vjenë Avarna dërguar ministrit të Jashtëm San Giuliano, Vjenë, 23 mars 1912.

⁹³ M. Shatri, *Kryengritja e përgjithshme shqiptare kundërosmane...*, f. 94.

⁹⁴ Ilir Ikonomi, *Esat Pashë Toptani: njeriu, lufta, pushteti*, Tiranë: UET Press, 2016, f. 27.

⁹⁵ AMAE në AIH, Fondi: Serie Politica “P” (1891 – 1916), Pacco 674, image 7847. Telegram i Nënkonsullit italian në Korfuz Labia për Ministrinë e Jashtme, Korfuz, 12 prill 1912.

⁹⁶ I. Ikonomi, *Esat Pashë Toptani: Njeriu, lufta, pushteti ...*, f. 28.

⁹⁷ AMAE në AIH, Fondi: Serie Politica “P” (1891 – 1916), Pacco 674, image 7408. Telegram i nënkonsullit italian në Korfuz Labia për Ministrinë e Jashtme, Korfuz, 26 mars 1912.

pritur shumë ftohtë nga ana e popullatës, madje ai shtonte se në ndonjë vend është kundërshtuar me protesta të forta.⁹⁸

Gjatë qëndresës në Berat, një pjesë e komisionit drejtuar nga Haxhi Adil Beu kishte dalë hapur dhe dhunshëm kundër kandidaturave të Ismail Qemal Bej dhe Aziz Pashës.⁹⁹ Udhëtimi i komisionit vijoi për në Janinë. Sipas informacioneve të Labia-s atje kishin filluar edhe përgatitjet për pritjen e ministrit që do të arrinte më 15 prill për të parë gjendjen nga afër. Ai u njoh me situatën nga afër dhe me kërkesat e këtij vilajeti. Ndër më kryesoret ishte çështja e shkollave në gjuhën shqipe por ministri nuk dha leje duke lënë në fuqi ligjin e Këshillit të Ministrave.¹⁰⁰ Në qëndrimin e tij në Janinë, ministri takoi edhe mitropolitin grek ku i paraqiti me shkrim ankesat që po përjetonte popullsia e kësaj zone. Ministri i premtoi se do të shihen me kujdes ankesat e tyre, ndërkohë i refuzoi kategorikisht kërkesën e gjuhës greke si gjuhë zyrtare të këtij vilajeti.¹⁰¹

Komisioni do të shkonte në Manastir që ishte një krahinë mjaft e tensionuar dhe në disa raste kishin ndodhur edhe rebelime kundër autoriteteve xhonturke. Pas një qëndrimi të shkurtër në Strugë, ministri udhëtoi për në Dibër. Gjendja në këto krahina ishte mjaft e tensionuar dhe popullsia kishte filluar të shprehë hapazi pakënaqësitë ndaj qeverisë. Në fund të marsit 1912, myslimanët e Dibrës protestuan kundër vjeljes së taksave.¹⁰² Pritja u bë nga autoritetet vendore, ndërsa pjesëmarrja e popullsisë ishte e ulët. Gjatë takimeve që pati në Dibër, ministri u përpoq të ftojë shqiptarët për bashkëpunim duke iu premtuar se qeveria do të angazhohej në zhvillimin e infrastrukturës rrugore, tregtisë, zejtarisë shumë çështje të tjera që lehtësonin vështirësitë e jetesës.

Një delegacion shqiptarësh nga krahina të ndryshme të sanxhakut i paraqitën ministrit një memorandum me anën e të cilit kërkonin: lirinë e mbajtjes së armëve; amnisti për shqiptarët e burgosur ose të mërguar, për dënime politike; përdorimin e shkronjave latine në mësimin e gjuhë shqipe; zotimin që të mos paguheshin tatime të tjera përveç një mexhidie

⁹⁸ *Po aty*, image 7784, 7785, 7786. Telegram i nënkonsullit italian në Korfuz Labia për Ministrinë e Jashtme, Korfuz, 2 prill 1912.

⁹⁹ *Po aty*, image 7844, 7845. Telegram i nënkonsullit italian në Korfuz Labia për Ministrinë e Jashtme, Korfuz, 12 prill 1912.

¹⁰⁰ M. Shatri, *Kryengritja e përgjithshme shqiptare kundërosmane...*, f. 96.

¹⁰¹ *Po aty*.

¹⁰² P. Bartl, *Myslmanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi ...*, f. 221.

për një shtëpi; emërimin në poste administrative të njerëzve me besim në popull.¹⁰³

Pasi u njoh me kërkesat e tyre, ministri deklaroi se ankesat do të merren në konsideratë dhe qeveria do t'i trajtonte ato me përparësi. Haxhi Adil Beu bëri disa ndryshime në forcimin e xhandarmërisë, zëvendësoi mytesarifin e Dibrës, emëroi disa oficerë dhe nëpunës të administratës.

Njëkohësisht iu kërkoi mbështetjen shqiptarëve për qeverinë por ata refuzuan pasi ishin të zhgënjyer me Komitetin “Bashkim e Përparim”. Autoritetet përpiqeshin të fshihnin situatën e rënduar në provincat shqiptare Elbasan-Dibër të vilajetit të Manastirit. Konsullata ruse në Manastir njoftonte se ministri u nis urgjentisht nga Korça për në Dibër për këtë qellim. Ajo shton se vizita e Haxhi Adil Beut nuk do të sjellë asnjë qetësim dhe as nuk do të përmirësojë situatën.¹⁰⁴ Në bisedën që kishte patur Gravez dhe Fulon me konsullin bullgar në Manastir ishin shprehur se kjo ishte një përpjekje e qeverisë osmane për të bindur opinionin për qëndrueshmërinë e Perandorisë Osmane¹⁰⁵. Referuar telegramit të konsullatës ruse në Shkup, thuhet se ministri donte t'i drejtonte personalisht bisedimet me shqiptarët, porse kriza në kabinetin qeverisës e detyroi atë të largohet para kohe.¹⁰⁶ Por udhëtimi i Haxhi Adil Beu shërbeu për t'u njohur nga afër dhe për të krijuar një panoramë të përgjithshme të situatës në vilajetet shqiptare.

Pati edhe raste kur ministri pranoi në parim gabimet e qeverisë siç ishte çështja e rritjes së taksave, nevoja e shkollave, ndryshime në administratë apo ndonjë kërkesë tjetër e mundshme për t'u plotësuar. Gjatë gjitha takimeve të zhvilluara në vilajetet shqiptare, Haxhi Adil Beu bënte premtime të mëdha. Kryesisht “Komisioni” iu premtoi shqiptarëve fillimin e punimeve publike në: hekurudha, rrugë, ura, porte, bonifikime,

¹⁰³ *Dokumente franceze për Shqipërinë dhe shqiptarët më 1912 ...*, vëll. II, f. 78-79. Njoftim i nënkonsullit të Francës në Manastir për Shkëlqesinë e tij zotin Poincaré, Kryeministër dhe ministër, Manastir, 21 maj 1912.

¹⁰⁴ *Dokumente ruse për lëvizjen kombëtare shqiptare më 1912 ...*, f. 81. Telegram i konsullatës së Ruisë, Manastir dërguar Ministrisë së Jashtme Sankt Petersburg Manastir 21 prill/4 maj 1912.

¹⁰⁵ R. Abdylë, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1911-1912 ...*, f. 178.

¹⁰⁶ *Dokumente ruse për lëvizjen kombëtare shqiptare më 1912 ...*, f. 92. Telegram i konsullatës së Ruisë në Shkup për ambasadën e Perandorisë në Kostandinopojë, Shkup, 12/25 maj 1912.

reforma në taksa, reforma ligjore si hapjen e disa shkollave, etj...¹⁰⁷ Nga ana tjetër përjashtuan disa zëvendësimeve në administratë, ministri përpiqej të forconte xhandarmërinë e ushtrinë si dhe të bënte propagandë politike për Komitetin “Bashkim e Përparim”.

S u m m a r y

THE EFFORTS OF THE OTTOMAN EMPIRE TO STABILIZE THE SITUATION
IN ALBANIAN TERRITORIES:
THE REFORMS COMMISSION OF HAXHI ADIL BEY
(FEBRUARY –APRIL 1912)

After the Parliament was dismissed in January 1912, the cabinet of Said Pasha was reconstructed. Part of it were people of great authority in the “Committee for Union and Prosperity” which got the support of the government and its press. The goal of the government was to strengthen its administrative and military position and to extinguish the conflicts within the Ottoman Empire. The appointment of Haxhi Adil Bey in the position of the Minister of Interior elicited credibility and optimism. He was entrusted and given full competence in directing the Reforms Commission in Albanian territories.

There were quite a few discontents among the people and they became even more profound when the leaders took their place at the head of the Albanian movement after the Parliament’s dismissal. The government had information on the upheaval movement that was being led by Albanian deputies. It was sure that the Committee with the Minister of Interior Haxhi Adil Bey at the head together with the foreign and Ottoman experts would calm down the discontents in the territories of Rumelia. The sending of the Minister from Istanbul found great echo even among diplomatic circles which expressed their skepticism about the success of this commission. During the journey they were confronted with difficulties where even physical assaults by Albanian rebels were not to be missed. The meetings he held in Albanian vilayets result to have encountered a cold welcome and indifference by the people, even

¹⁰⁷ AMAE në AIH, Fondi: Serie Politica “P” (1891 – 1916), Pacco 674, image 7784, 7785, 7786. Telegram i nënkonsullit italian në Korfuz Labia për Ministrinë e Jashtme, Korfuz, 2 prill 1912.

though Haxhi Adil Bey tried to tempt them by many promises, he dealt out a considerable amount of money so that they did not rebel against the government and invited them to support the “Committee for Union and Prosperity” during the elections of spring 1912.

Also part of his mission was to enforce the army and the gendarmerie and to make changes within the administration.

The efforts of the Minister of Interior to regain the trust of Albanians, to stop the national development and the armed resistance failed.

Finally Haxhi Adil Bey couldn't make it to prevent the upheaval movement of Albanians and his mission resulted as unsuccessful.